



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.8 Regj.Them.
Datë Rregj.05.04.2023

Nr. 8 VENDIMI
Datë 11.04.2023

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtar: Sokol IBI (Relator)
Gjyqtare: Esmeralda XHILI (Anëtare)
Gjyqtare: Edlira PETRI (Anëtare)
Gjyqtare: Manjola XHAXHO (Anëtare)
Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (Anëtare)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 11.04.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.8 akti, datë 05.04.2023 që i përket:

PADITËS: **Mehmet Nelaj**, i biri i Sheref dhe Shano i datëlindjes 10.03.1949 lindur ne Tepelenë dhe banues Lagjia Nr.1, Sarandë, i përfaqësuar në gjykim me deklaram në seancë nga Av: Zhuljen Ristani.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me autorizim me nr. 3634 Prot datë 11.04.2023 nga Z.Erdal Mema dhe Ina Osmanaj.

OBJEKTI: Kundërshtimin e vendimit nr. 38, datë 31.03.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndryshimin e tij duke pranuar kërkesën për regjistrimin e paditësit Mehmet Nelaj si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak Sarandë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

BAZA LIGJORE: Neni 70 e vijues i Kodit Zgjedhor të Republikës së

Shqipërisë

Kolegji Zgjedhor pasi shqyrtoi provat në tërësi, dëgjoi pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, si dhe palës së paditur që kërkoi rrëzimin e padisë,

VËREN:

1. Pala paditëse Mehmet Nelaj i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt “*Ndryshimi i vendimit nr. 38, datë 31.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve*”. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitim dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, paditësi Mehmet Nelaj ka depozituar në datë 07.03.2023 dokumentacionin e kandidimit të tij si kandidat i pavarur për anëtar të Këshillit Bashkiak Sarandë, në KZAZ nr. 90.

3. KZAZ nr. 90 e Bashkisë Sarandë me vendimin nr. 17, datë 27.03.2023, ka vendosur refuzimin e kërkesës për regjistrimin si kandidat të z. Mehmet Nelaj, për shkak të mungesës së komitetit nismëtar, që është i vetmi organ i parashikuar nga ligji që mund të kërkojë regjistrimin e një kandidati të pavarur pranë KZAZ.

4. Paditësi duke mos qenë dakord më vendimin nr. 17, datë 27.03.2023 të KZAZ Nr.90, i është drejtuar me ankim Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë KQZ-së, ku kundërshton vendimin Nr.17, datë 27.03.2023 të KZAZ Nr.90.

Paditësi pretendon se: “*dokumentet e dorëzuara nga ana e tij janë dokumentet tip të përdorura për regjistrimin e kandidatëve në zgjedhjet për qeverisjen vendore të vitit 2019, pasi nuk ishte në dijeni të formatit të dokumenteve të kërkuara për zgjedhjet*

vendore të 14 majit 2023. Ankuesi pretendon se fakti që zotëron mandatin e vlefshëm të këshilltarit bashkiak në bashkinë Sarandë, e përjashton nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të nenit 70, ku flitet për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Për këto arsye ankuesi kërkon regjistrimin e tij si kandidat për Këshillin Bashkiak Sarandë”.

5. Në seancën e datës 31.03.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mori në shqyrtim kërkesën ankimore të paditësit Mehmet Nelaj e në përfundim të hetimit administrativ, ka disponuar me vendimin nr. 38, datë 31.03.2023. Bazuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 143 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar me shumicë votash vendosi:

“1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 40, datë 30.03.2023 të paraqitur nga z. Mehmet Nelaj.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 17, datë 27.03.2023 të KZAZ-së nr. 90, Bashkia Sarandë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij”.

6. Referuar vendimit të marrë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezultoi se:

1. Ankuesi Mehmet Nelaj ka kërkuar të regjistrohet si kandidat i pavarur, pa kaluar nëpër procedurën e regjistrimit fillimisht të një “komiteti nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin”, sikurse kërkon pika 3 e nenit 70 të Kodit Zgjedhor. Ankuesi ka zgjedhur këtë rrugë procedurale mbështetur në praktikën e regjistrimit të kandidatëve në zgjedhjet për qeverisjen vendore të vitit 2019, bile, siç e pohon vetë, duke përdorur dokumentacionin tip për regjistrimin e kandidatëve në ato zgjedhje.

2. Pika 3 e nenit 70 të Kodit Zgjedhor përcakton se afati për regjistrimin e komitetit nismëtar është “jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve”. KZAZ-ja nr. 90 Sarandë ka konstatuar faktin juridik të mungesës së komitetit nismëtar dhe mbi këtë bazë, ka refuzuar regjistrimin e kandidatit. KZAZ-ja nr. 90 nuk mund t’i jepte mundësinë ankuesit që, në procedurë korrigjimi të dokumentacionit, të plotësonte këtë mangësi. Subjekti që kërkon regjistrimin e kandidatit të pavarur është komiteti nismëtar dhe jo anasjelltas. Vetëm komiteti nismëtar mund të vërë në lëvizje KZAZ-

në për regjistrimin e kandidatit. Kandidati vetë nuk e ka këtë tagër, sepse Kodi Zgjedhor nuk e njeh mekanizimin e vetkandidimit.

3. Pretendimi se zotërimi i një mandati të vlefshëm këshilltari bashkiak e bën të panevojshëm regjistrimin në zgjedhje të komitetit nismëtar, sepse bën të panevojshme mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse nuk qendron. Ky pretendim mbështetet mbi një lexim të gabuar të dispozitës së pikës 4 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor. Pika 4 çliron kandidatin me mandat vetëm nga detyrimi për të mbledhur nënshkrime mbështetëse nga zgjedhësit, por nuk vendos një procedurë të ndryshme regjistrimi për ta.

4. Procedura e regjistrimit bëhet e qartë edhe nga udhëzimi i Komisionerit nr. 1, datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, sipas të cilit regjistrimi i kandidatit të pavarur kërkohet domosdoshmërisht nga komiteti nismëtar (nenet 5 dhe 6 të udhëzimit).

5. Fakti se ankuesi është orientuar në procedurën e regjistrimit nga praktika e zgjedhjeve të mëparshme dhe jo nga kuadri ligjor i qartë dhe preciz, nuk mund të konsiderohet shkak për “tolerancë”. Si KZAZ-ja nr.90, ashtu dhe KAS-i nuk kanë asnjë hapësirë për diskrecion në një situatë të tillë, sepse neni 11 i Kodit të Procedurave Administrative nuk lejon ushtrimin e diskrecionit në tejkalim të kufijve të ligjit (shkronja “b” e nenit 11).

6. Për më tepër, KAS-i nuk mund të prishë vendimin e KZAZ-së, sepse prishja e vendimit do të nënkuptonte se KZAZ-ja nr. 90 ka shkelur ligjin kur ka vendosur mosregjistrimin e ankuesit në zgjedhje. E vërteta është se KZAZ-ja ka zbatuar me përpikëri ligjin kur ka ndërmarrë këtë akt. Udhëzimi i Komisionerit nr. 1, datë 18.01.2023 i kërkon shprehimisht KZAZ-së që kur shqyrton dokumentat e kandidimit të verifikojë paraprakisht nëse Komiteti Nismëtar që propozon një kandidat është regjistruar apo jo (shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7).

Prandaj KAS-i duhet të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 40 dhe të lërë në fuqi vendimin nr. 17, datë 27.03.2023 të KZAZ-së nr. 90, Sarandë”.

7. Ky vendim i KAS kundërshtohet në këtë gjykim nga paditësi Mehmet Nelaj, i cili në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesi të tij, ka pretenduar se:

Paditësi Mehmet Nelaj është aktualisht anëtar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Sarandë, mandat ky i fituar nga kandidimi në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019. Ai dëshiron të kandidojë përsëri për anëtar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Sarandë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për këtë arsye ka ndjekur procedurat përkatëse për regjistrimin e tij si kandidat në K.Z.A.Z. nr. 90 Sarandë.

Kodi Zgjedhor, në nenet 63 e vijues të tij rregullon regjistrimin e subjekteve zgjedhore. Neni 63 i Kodit Zgjedhor, ndër të tjera, parashikon se:

- “1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.*
- 2. Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.*
- 3. Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendore në KZAZ”.*

Paditësi Mehmet Nelaj e ka klasifikuar veten si subjekt zgjedhor i propozuar si kandidat për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish.

Neni 70 i Kodit Zgjedhor përcakton mënyrën e regjistrimit për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, duke parashikuar konkretisht se: “1.Një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për kryetar të bashkisë ose një kandidat për këshillin vendor jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve.

2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë 36 partie apo koalicioni që konkurron në atë zonë zgjedhore dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron në atë zonë zgjedhore.

3. Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod.

4. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Në këtë rast kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit”.

KZZAZ Nr. 90 Sarandë me vendimin nr. 17, date 27.03.2023, ka vendosur të mosregjistrojë paditësin si kandidat, me arsyetimin se “nuk është regjistruar komitet nismëtar sipas përcaktimeve ligjore brenda datës 06.03.2023”.

Kundër këtij vendimi paditësi Mehmet Nelaj ka paraqitur ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili me vendimin nr.38, date 31.03.2023, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës ankimore të paraqitur nga Mehmet Nelaj”.

Në kushtet e mësipërme, paditësi Mehmet Nelaj ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, i cili me vendimin nr.8 regjistri themeltar, date 06.04.2023, ka vendosur që ankuesi Mehmet Nelaj të plotësojë të metat e ankimit, nëpërmjet paraqitjes së padisë me palë kundërshtare brenda një afati jo me vonë se 24 orë nga data e gjykimit 11.04.2023, ora 15.00.

Në këto kushte paditësi Mehmet Nelaj, i është drejtuar me padi Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, nga i cili kërkon “Kundërshtimin e vendimit nr.38, date 31.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

Paditësi Mehmet Nelaj në kërkesëpadi është pretendon se si K.Z.A.Z. nr. 90 Sarandë ashtu dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë marrë vendime në zbatim të gabuar të ligjit dhe në vlerësim të gabuar të akteve të paraqitura nga paditësi Mehmet Nelaj.

Zbatimi i gabuar i ligjit konsiston në faktin se arsyetimi i bërë nga K.Z.A.Z. Sarandë dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vjen në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 70 të Kodit Zgjedhor. K.Z.A.Z. Sarandë dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë gabuar kur kanë nxjerrë si konkluzion se është kusht i domosdoshëm krijimi një komitet nismëtar në rastin që qëllimi i këtij komiteti nismëtar është propozimi si kandidat i një shtetasi që zotëron mandat në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore që do të kandidojë sërish.

Pika 3 e nenit 70 të Kodit Zgjedhor përcakton qartazi funksionin e komitetit nismëtar, duke parashikuar se “3. Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtareve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar bashkie vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondojnë 1 % të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore por, në çdo rast jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod”.

Nga vetë dispozita rezulton se komiteti nismëtar, së pari është i ngarkuar me mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin dhe së dyti, nëse arrin të mbledhë 1% të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, atëherë mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë ose për anëtar të këshillit bashkiak.

Qëllimi i komitetit nismëtar del dhe nga interpretimi i pikës 4 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor. Përveç fjalisë së parë që qartazi nënkupton se në rastin e zotërimit të mandatit, nuk mblidhen firma mbështetëse për kandidatin, është fjalia e dytë ajo që e qartëson më tej edhe moskrijimin e komitetit nismëtar, pasi ligjvënësi, paraqitjen e vërtetimit me shkrim të nënshkruar nga njësitë e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit, ja ngarkon kandidatin dhe jo komitetin nismëtar dhe ky vërtetim është paraqitur nga paditësi Mehmet Nelaj.

Ligji në rastin konkret nuk kërkon që duhet krijuar një komitet nismëtar kur kandidati nuk e ka detyrim mbledhjen e firmave për atë kohë sa zotëron një mandat aktual. Vlen për t'u theksuar gjithashtu se në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, paditësi Mehmet Nelaj është regjistruar si subjekt zgjedhor, në zbatim të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit që zotëronte një mandat, pa regjistruar më parë një komitet nismëtar.

Për atë kohë sa paditësi Mehmet Nelaj, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor nëpërmjet të njëjtit dokumentacion (pa krijuar paraprakisht një komitet nismëtar) si ai i depozituar për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, vendimmarrja e tanishme e vë Komisionin Qendror i Zgjedhjeve përpara mbajtjes së standarteve të ndryshme të zbatimit të ligjit dhe përpara parimit themeltar ligjor të moscenimit të sigurisë juridike.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, më konkretisht në vendimin nr. 43. datë 06.10.2011, ka arsyetuar ndër të tjera se:

“35. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbejnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë për sipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesat dhe pritshmëritë të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasojat pozitive, konkretisht trajtim me të mirë financiar për subjektet përfituese”.

Në rastin objekt shqyrtimi administrativ, paditësit Mehmet Nelaj i është mohuar një pritshmëri e ligjshme e tij pa ndryshuar legjislacioni, por vetëm nëpërmjet

interpretimit të ndryshëm që anëtarët aktuale të KZAZ dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i kanë bërë nenit 70 të Kodit Zgjedhor.

Fakti që citohet në vendimin nr.38, date 31.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve se, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka nxjerrë Udhëzimin nr. 1, datë 18.01.2023 për “Përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, nëpërmjet të cilit, me interpretim të zgjeruar, komitetin nismëtar e konsideron si kusht sine qua non për regjistrimin e një kandidati që zotëron mandat në këshillin bashkiak sipas nenit 70 pika 4 të K.Zgjedhor, është interpretim i gabuar dhe kufizues i Kodit Zgjedhor. Një e drejtë që njihet nga ligji (Kodi Zgjedhor), nuk mund të kufizohet me akt nënligjor.

Përsa i përket pjesës të vlerësimit të materialeve dokumentare të shqyrtuara nga KZAZ nr.90 dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vërejmë faktin se nga ana e tyre nuk janë mbajtur në konsideratë disa dokumenta që paditësi Mehmet Nelaj ka dorëzuar në KZAZ nr.90 Sarandë dhe që tregojnë faktin se pavarësisht përjashtimit që i bën ligji rastit të tij nga detyrimi i krijimit të komitetit nismëtar, nga Mehmet Nelaj është depozituar në datën 27.03.2023 edhe Formulari Model KQZ-04-05, “Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit”, në të cilin rezulton të pasqyrohet ekzistenca e Komitetit të tij Nismëtar, të përbërë nga shtetasit Arben Lipe, Shpetim Isaj, Gerd Nelaj, Shkëlqim Hajno, Valbona Mehmeti, Ali Beshiri, Gani Çiçaj, Sovjet Maska dhe Luiza Maska, në total 9 persona sa kërkon neni 70 i Kodit Zgjedhor, firmosur rregullisht nga këta shtetas dhe bashkangjitur kartat e tyre të identitetit.

Në themel konstatimi i KZAZ nr. 90 Sarandë dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve se, paditësi Mehmet Nelaj nuk ka ezauruar procedurën e regjistrimit nëpërmjet Komitetit Nismëtar rezulton i gabuar, pasi ai ka dorëzuar të plotësuar rregullisht formularin e kërkuar nga ligji. Fakti i dorëzimit të këtij formulari provohet edhe nga procesverbali i dorëzimit të dokumenteve të kandidimit, i firmosur rregullisht nga përfaqësuesi i KZAZ nr. 90 Sarandë, shtetasi Ervis Mehmeti. Konstatojmë se Formulari Model KQZ-04-05. “Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit”, nuk ka qenë pjesë e dokumentave mbi bazën e të cilave ka shqyrtuar ankimin Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithsesi paditësi Mehmet Nelaj i disponon kopjet e këtyre akteve, të cilat i ka paraqitur si prova Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Përfundimisht rezulton e provuar pretendimi i paditësit Mehmet Nelaj se, si K.Z.A.Z. nr.90 Sarandë ashtu dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë marrë vendime në zbatim të gabuar të ligjit dhe në

vlerësim të gabuar të akteve të paraqitura nga paditësi Mehmet Nelaj duke kërkuar nga Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Kundërshtimin e vendimit nr.38, date 31.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndryshimin e tij duke pranuar kërkesën për regjistrimin e paditësit Mehmet Nelaj si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak Sarandë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

8. Pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit ka pretenduar se:

Neni 70, pika 3, e Kodit Zgjedhor përcakton mënyrën e kandidatit për të garuar në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore si kandidat i pavarur. Kandidati që shpreh interesin e ligjshëm për të garuar në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore duhet të propozohet nga një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore përkatëse, të cilët duhet të krijojnë një Komitet Nismëtar (i përbërë nga jo më pak se 9 zgjedhës), të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin.

Faktet dhe provat tregojnë se paditësi z. Mehmet Nelaj, nuk e ka kryer këtë procedurë, pasi nuk ka një Komitet Nismëtar të regjistruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të ngarkuar për të mbledhur firmat për kandidatin.

Paditësi është shprehur se ka përdorur dokumentacionin tip për regjistrimin e kandidatëve që është përdorur në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019, pasi sipas tij nuk kishte dijeni mbi kuadrin ligjor ekzistues. Mosnjohja e ligjit nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia për të zbatuar kërkesat e përcaktuara qartë në ligj për dorëzimin e dokumentacionit të kandidimit.

Përsa i përket pretendimit të paditësit se zotëron mandat si këshilltar në këshillin bashkiak, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shprehet se, zotërimi i këtij mandati nuk e bën të nevojshme mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse. Pika 4, e nenit 70, të Kodit Zgjedhor çliron kandidatin që zotëron mandatin vetëm nga detyrimi për të mbledhur nënshkrime mbështetëse nga zgjedhësit, por nuk vendos një procedurë të ndryshme për regjistrimin e tyre.

Udhëzimi nr. 1, datë 18.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, udhëzon KZAZ-në, mbi verifikimin e dokumentacionit të kandidimit të depozituar nga kandidatët që garojnë në zgjedhje.

Neni 7, pika 1, shkronja "b", e tij përcakton qartazi se KZAZ kryen verifikimin e dokumentacionit të kandidimit në lidhje me përputhshmërinë e tij me kërkesat e

neneve 67, 68 dhe 72, të Kodit Zgjedhor, duke ndjekur këtë radhë veprimi: b) Verifikimin nëse Komiteti Nismëtar që propozon një kandidat është regjistruar".
Përfundimisht pala e paditur kërkoi:

Rrëzimin e kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi z. Mehmet Nelaj;

Lënien në fuqi të vendimit nr. 38, datë 31.03.2023 "Për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 40, datë 30.03.2023 paraqitur në KQZ nga z. Mehmet Nelaj, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

II. DISPOZITA LIGJORE TË ZBATUESHME

KODI ZGJEDHOR

Neni 63

Subjektet zgjedhore dhe kandidatët

...2. Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.

Neni 70

Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore

1. Një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për kryetar të bashkisë ose një kandidat për këshillin vendor jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve.
2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurren në atë zonë zgjedhore dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurren në atë zone zgjedhore.
3. Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondojnë 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod.
4. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në

pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Në këtë rast kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit.

UDHËZIM PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEPOZITIMIN DHE VERIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT TË KANDIDIMIT, AFATET PËR PUBLIKIMIN E LISTAVE TË KANDIDATËVE DHE MIRATIMIN E MODELEVE TË KANDIDIMIT PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE Nr.1, datë 18.01.2023

Neni 7

Verifikimi i dokumentacionit të kandidimit të depozituar në KZAZ

1. KZAZ kryen verifikimin e dokumentacionit të kandidimit në lidhje me përputhshmërinë e tij me kërkesat e neneve 67, 68 dhe 72, të Kodit Zgjedhor, duke ndjekur këtë radhë veprimi:

b) Verifikon nëse Komiteti Nismëtar që propozon një kandidat është regjistruar;

III. INTERPRETIMI I DISPOZITAVE LIGJORE TË ZBATUESHME

Sipas nenit 63/2 të K.Zgjedhor, subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me kusht që të ketë të drejtë vote, të propozohet si kandidat për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, të propozohet sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.

Në nenin 70 të K.Zgjedhor përcaktohet procedura që duhet të respektojnë kandidatët e pavarur për tu regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Në nenin 70/1 të K.Zgjedhor parashikohet se, vetëm një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat të pavarur për këshillin vendor jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve.

Në nenin 70/3 të K.Zgjedhor, parashikohet procedura që duhet të ndjekë ky grup zgjedhësish për të propozuar një kandidat të pavarur për këshillin vendor.

Ky grup zgjedhësish që do të propozojë kandidatin e pavarur krijon “komitetin nismëtar” dhe e regjistrojnë komitetin nismëtar në KZAZ jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit.

Komiteti nismëtar është një grup zgjedhësish që propozojnë dhe mbështesin një kandidat për në këshillin vendor. Komiteti Nismëtar përbëhet nga jo më pak se 9

zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse. Kusht për tu regjistruar në KZAZ ky komitet nismëtar është, të përbëhet nga jo më pak se 9 anëtarë zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të propozojnë dhe mbështesin një kandidat të pavarur për në organet e qeverisjes vendore. Kompetencë e komitetit nismëtar është të mbledhë firmat mbështetëse nga zgjedhësit e zonës, për kandidatin që ata kanë propozuar për në organet e qeverisjes vendore.

Komiteti nismëtar mund të regjistrojë një kandidat për organet e qeverisjes vendore vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korespondojnë 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore por, në çdo rast jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod.

Sipas nenit 70/4 të K.Zgjedhor, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Këta kandidatë përjashtohen nga detyrimi për mbledhjen e firmave mbështetëse (1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore por, në çdo rast jo më pak se 50 zgjedhës), nëse kanë qenë anëtarë të këshillave të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse të paktën 6 muajt e fundit. Këta kandidatë të pavarur nuk përjashtohen nga detyrimet e tjera të parashikuara në K.Zgjedhor, si kusht për tu regjistruar në KZAZ si subjekte zgjedhore. Kështu këta subjekte nuk përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në nenin 70/1 i K.Zgjedhor, që duhet të jenë propozuar si kandidatë për tu zgjedhur në organet e qeverisjes nga një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore përkatëse. Ky grup zgjedhësish propozues është pikërisht i ashtuquajturit “komiteti nismëtar” i cili përbëhet nga jo më pak se 9 zgjedhës të cilët regjistrohen si të tillë në KZAZ. Kjo do të thotë se regjistrimi i kandidatit të pavarur për në organet e qeverisjes vendore nuk mund të kryhet në KZAZ, nëse ai nuk është propozuar nga komiteti nismëtar pavarësisht nëse ka pasur apo jo një mandat në këshillin e bashkisë të paktën 6 muajt e fundit. Ky konkluzion bazohet jo vetëm në nenin 70/1 dhe 70/3 të K.Zgjedhor, por edhe në udhëzimin Nr.1, datë 18.01.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, neni 7/1 pika “b”.

IV. VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR:

9. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, pretendimet dhe kërkimet në padi të paditësit janë të pabazuara në prova dhe në ligj dhe padia e paditësit duhet rrëzuar.

Vendimi Nr.17, datë 27.03.2023 i KZAZ Nr.90 si dhe vendimi Nr.38, datë 31.03.2023 i KAS janë akte të ligjshme dhe të vlefshme.

Ato vendime kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 70 të K.Zgjedhor si dhe të ushëzimit Nr. 1, datë 18.01.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Pavarësisht faktit se paditësi rezulton se është mbajtës i mandatit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak Sarandë të paktën 6 muaj e fundit, ai nuk përjashtohet nga detyrimi i parashikuar në nenin 70/1 të K.Zgjedhor, si kusht për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore për organet e qeverrisjes vendore të 14 maj 2023.

Paditësi nuk rezulton të jetë propozuar si kandidat i pavarur për këto zgjedhje nga një grup zgjedhësish. Për tu propozuar si i tillë paditësi nuk mjafton të paraqesë nënshkrimet e 9 zgjedhësve që e propozojnë si të tillë, por këta 9 zgjedhës duhet të jenë regjistruar paraprakisht në KZAZ si komitet nismëtar, jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve. Është ky grup nismëtar ai që propozon emrin e paditësit si kandidat për tu zgjedhur në këto zgjedhje vendore.

Pasja e mandatit të këshilltarit prej të paktën 6 muajt e fundit e përjashton paditësin dhe komitetin nismëtar nga detyrimi për të mbledhur firmat mbështetëse për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por jo edhe nga detyrimi për krijimin dhe regjistrimin e komitetit nismatar.

Paditësi nuk e ka regjistruar komitetin nismëtar në KZAZ Nr.90 sipas formularit model KQZ 04-04. Paditësi ka plotësuar vetëm formularin 04-05 “Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit”.

Komiteti nismëtar nuk ka vetëm rolin e mbledhësit të nënshkrimeve të mbështetësive të paditësit, por roli parësor i tij është edhe propozimi dhe mbështetja e paditësit si kandidat për anëtar të Këshillit të Bashkisë Sarandë, e për ta përmbushur këtë detyrë sipas ligjit, ky komitet nismëtar duhej të ishte regjistruar paraprakisht në KZAZ, gjë që nuk ka ndodhur në rastin konkret. Në të tilla rrethana me të drejtë KZAZ Nr.90 nuk ka regjistruar paditësin si kandidat për në zgjedhjet vendore të 14 Maj 2023. Po kështu me të drejtë KAS ka rrëzuar kërkesën e tij ankimore.

Pretendimet në padi të paditësit janë të pabazuara në prova dhe në ligj dhe duhen rrëzuar nga Kolegji Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Rrëzimin e padisë.
 2. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.
 3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë, në datë 11.04.2023.

GJYQTARE
Alma KOLGJOKA

GJYQTARE
Esmeralda XHILI

GJYQTAR
Sokol IBI

GJYQTARE
Edlira PETRI
(Kundër)

GJYQTARE
Manjola XHAXHO
(Kundër)